

MACROSAN RINZAFFO

MBUSHJE/SHTRESIM PER PATINIM ANTIKRIPE

Karakteristikat

MACROSAN MBUSHJE ME LLAÇ është një përbërje inorganike që përgatitet duke përzier disa lidhës hidraulikë, lëndë inerte të përzgjedhura sipas grafikut të caktuar të thërmimit dhe frenuesve shtesë të kripësive sipërfaqësore.

I përzier me ujë krijon një solucion për mbushje me llaç të pasur me hapësira të vogla ajri, komunikuese mes tyre, në gjendje për të stabilizuar dukuritë degraduese të ushtruara nga hidroskopja e sulfateve dhe në të njëjtën kohë duke lejuar kalimin e lagështisë drejt mjedisit të jashtëm në gjendje të avullit.

MACROSAN MBUSHJE ME LLAÇ përbën në këtë mënyrë një lidhje/mbërthim optimal për mbushjen e mëvonshme me suva jo lagështitëse. **MACROSAN TE PERQENDRUAR**, **MACROSAN TE GATSHEM** ose **TECHNOSAN SUVA** që, nëpërmjet rritjes së konsiderueshme të sipërfaqes avulluese, të provokojë një proces natyral dhe konstant të largimit të lagështisë që ka suvatimi.

Fusha e përdorimit

Përdoret në çdo lloj muri të cënuar nga lagështira si nxitës për lidhje dhe filtër antikripor.

Avantazhe

- Rrit nivelin e ngjeshjes së suvasë jo lagështitëse
- Inerte ndaj veprimit të sulfateve
- Jashtëzakonisht poroze
- E përdorshme me makineri suvatimi.

Materialet e duhura

Muraturë me tulla, shtuf, gurë dhe përzierje e osmotikë të papërshkueshëm

Përgatitje e sipërfaqeve

Pastro me kujdes, të paktën një metër mbi shenjën e dukshme të lagështirës, muraturën duke eliminuar gjithë materialin që nuk është përputhur si duhet, gjurmët e punimeve dhe trajtimet e mëoarshme. Hiq depozita të mundshme kripore. Mbush hapësirat e mëdha ose jashtë vijës së plumbçit me solucionin **MACROSAN TE GATSHEM** ose **TECHNOSAN** të përziera me copa të thyera tullash.

Mënyra e përdorimit

Përziej **MACROSAN MBUSHJE ME LLAÇ** në betonierë me gota për të paktën 5 min me rreth 18% ujë të pastër (4.5l për çdo thes nga 25 kg), derisa përgatitet një tretësirë me karakteristikat e përshtatshme për të kryer mbushjen/suvatimin.

Në rastin e përdorimit me makineri, rregullo fluksin e ujit në funksion të punës së kërkuar, që jep mundësinë e punimit të sipërfaqeve mjaft të ashpra.

Para aplikimit të **MACROSAN RINZAFFO**, të lahet mirë paret që duhet trajtuar për të eliminuar çdo gjurmë e floreshencash kripore dhe më parë të aplikohet **MACROSAL**.

Më pas të procedohet me aplikimin e **MACROSAN RINZAFFO** me mistri ose suvatuese deri në mbulimin e plotë të paretit, duke realizuar një trashësi të mesme 5-7 mm.

Të lihet e paprekur për 24 orë, të laget e më pas të vijohet me aplikimin e suvasë së **MACROSAN PRONTO** (1 thes prej 25 kg me 4/4.5 l ujë) ose **MACROSAN CONCENTRATO** apo **MACROSAN PRONTO CALCE** (1 thes prej 20 kg me 4-5 kova rërë të trashë dhe 15 l ujë) për një trashësi rreth 2 cm, ose **TECHNOSAN**.

Të dhënat teknike* dhe aplikative**

* Pamja	pluhur ngjyrë gri lajthi
* Pesha specifike e llaçit të freskët	rreth 1.800 kg/m ³
* Ambalazhimi	thes 25 kg
* Konsumi i mesëm/5-7mm trashësi	7 kg pluhur/m ²
* Uji i përzierjes	rreth 18 %
* Uji i përzierjes për suvatuesen	në funksion të plasticitetit
* Qëndrueshmëria në shtypje (28 ditë)	11 N/mm ²
* Diametri max inert	3 mm
* Koha e përzierjes	rreth 5 min
* Përshkueshmëria ndaj avullit	μ<15
* Trashësia optimale	5-7 mm
* Temperatura e përdorimit	+5 / +35° C
* Koha e ruajtjes	12 muaj nëse mbahet në vend të thatë e të freskët në ambalazhin origjinal të vulosur
** Betonierë, shtalka anësore, perdah, mistri, suvatuese	

Paralajmërime

- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku fryn erë e fortë apo në pishë të diellit
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira ose që mund të ngrihen gjatë 24 orëve të ardhshme
- ** Mos i shtoj ujë apo tjetër gjë produktit të përzier
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe allçie
- ** Mbaje suvanë larg përqendrimeve të ujit
- ** Në rast temperaturash të larta mbaje sipërfaqen të lagur për 24 orë

Qëndrueshmëri mekanike: Qëndrueshmëritë mekanike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të ambalazhuara në laborator me 18 % ujë dhe të maturuara në 20°C dhe U.R. 90%. Të dhënat mund të ndryshojnë ndërkohë që ndryshojnë kushtet e përzierjes e të staxhionimit.

Vërejt! Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.